



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 173, datë 26.10.2017

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART TRADE & CONSULTING SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma ”d” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Bordi i ERE me Vendimin nr. 166, datë 12.10.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “SMART Trade & Consulting” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren per procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”,

“d”, “e”, “f”, “g”) është plotëuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4/10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k, në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI